



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agjencia za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



Statistikat e Hotelerisë

Maj 2022

Prishtinë, 08.08.2022: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e Statistikave të Hotelerisë Maj 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin me të dhëna për aktivitetin Hotelier në Kosovë, lidhur me numrin e vizitorëve vendor dhe të jashtëm dhe netqëndrimet e tyre. Ky publikim statistikor paraqet të dhëna statistikore për muajin Maj të vitit 2022.

Burimet e të dhënave janë hotelet dhe njësitë tjera akomoduese të klasifikuara në aktivitetin e hotelerisë dhe turizmit sipas NACE-Rev.2.

Qëllimi i publikimit është që të vejë në dukje tendencën e zhvillimit të këtij aktiviteti ekonomik në Kosovë.

Duke u bazuar në kërkesa të vazhdueshme nga shfrytëzues të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm për të dhëna dhe informacione statistikore si dhe duke shfrytëzuar rekomandimet dhe manualët e EUROSTAT-it mbi indikatorët që duhet të publikohen për statistikën e hotelerisë, kemi prezantuar informacione me interes.

Ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së, dhe si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund ti dërgoni në adresën elektronike:
economic@rks-gov.net.

Publikimin e përgatitën :

Ismail Sahiti - Zv. Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike
Sulltane Gashi - Zyrtare për Statistika Ekonomike
Mergime Shala - Zyrtare për Statistika të Ndërmarrjeve

Gusht, 2022

Zv. Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,
z. Ilir T. Berisha

Për t'u konsultuar me publikime të tjera, vizitoni faqen e ASK: <http://ask.rks-gov.net>

Në Republikën e Kosovës, në muajin Maj 2022, krahasuar me muajin Maj 2021, numri i vizitorëve vendore ka pasur rritje për 50.0% ndërsa netqëndrimet e tyre janë rritur për 44.7%.

Në muajin Maj 2022, krahasuar me muajin Maj 2021, numri i vizitorëve të jashtëm ka pasur rritje për 53.1% ndërsa numri i net qëndrimeve të tyre është rritur për 58.8%.

Tab. 1: Numri i vizitorëve dhe netqëndrimet e tyre sipas regjioneve

	Total			Vendor			Të jashtëm		
	V	V	indeksi	V	V	indeksi	V	V	indeksi
	2021	2022	V 2022 V 2021	2021	2022	V 2022 V 2021	2021	2022	V 2022 V 2021
	2021	2022	V 2021	2021	2022	V 2021	2021	2022	V 2021
	Vizitorët								
Republika e Kosovës	21.352	32.444	151,9	8.030	12.042	150,0	13.322	20.402	153,1
Gjakovë	288	396	137	104	61	59	184	335	182
Gjilan	705	1.044	148	372	781	210	333	263	79
Mitrovicë	2.139	2.440	114	441	1.239	281	1.698	1.201	71
Pejë	3.622	2.532	70	1.829	1.329	73	1.793	1.203	67
Prizren	6.453	6.588	102	2.718	2.866	105	3.735	3.722	100
Prishtinë	6.903	15.223	221	1.797	2.612	145	5.106	12.611	247
Ferizaj	1.242	4.221	340	770	3.154	410	472	1.067	226
	Netqëndrimet								
Republika e Kosovës	32.624	50.247	154,0	11.145	16.129	144,7	21.479	34.118	158,8
Gjakovë	646	611	95	166	110	67	480	501	104
Gjilan	830	1.191	143	402	814	202	428	376	88
Mitrovicë	2.199	2.497	114	438	1.279	292	1.761	1.219	69
Pejë	9.229	4.595	50	3.956	2.422	61	5.273	2.173	41
Prizren	7.190	9.357	130	2.920	3.775	129	4.270	5.582	131
Prishtinë	10.616	24.358	229	2.346	4.210	179	8.271	20.148	244
Ferizaj	1.913	7.639	399	918	3.519	383	995	4.119	414

Tab. 2: Numri i vizitorëve dhe net qëndrimet e tyre, sipas shteteve prej nga vijnë


	Vizitorët			Netqëndrimet		
	V	V	indeksi	V	V	indeksi
			<u>V 2022</u>			<u>V 2022</u>
2021	2022	V 2021	2021	2022	V 2021	
Të jashtëm	13.322	20.402	153,1	21.479	34.118	158,8
Austria	386	582	151	537	777	145
Belgjika	182	300	165	361	538	149
Bosna & Hercegovina	90	157	175	125	548	439
Britania e Madhe	437	469	107	511	604	118
Franca	257	393	153	394	485	123
Gjermania	1.258	1.749	139	2.422	3.207	132
Greqia	80	100	125	149	155	104
Holanda	77	227	295	155	275	177
Italia	366	657	180	1.145	1.398	122
Kroacia	632	486	77	1.570	982	63
Mali I Zi	265	515	194	456	698	153
Maqedonia	614	740	121	852	1.010	118
Polonia	47	97	207	56	123	221
Serbia	682	577	85	1.060	971	92
SHBA	520	1.114	214	805	1.367	170
Shqipëria	4.123	3.175	77	5.565	5.705	103
Slllovenia	158	327	207	336	578	172
Spanja	82	125	153	151	184	122
Turqia	698	1.432	205	1.226	2.136	174
Zvicra	1.096	1.857	169	1.557	2.989	192
Të tjera	1.274	5.322	418	2.045	9.386	459

Në Maj 2022 numri më i madh i vizitorëve të huaj është nga Shqipëria, Zvicra dhe Gjermania.

Tab. 3: Shfrytëzimi i kapaciteteve hoteliere sipas shtretërve

Shfrytëzimi i kapaciteteve	(%)	
	V 2021	V 2022
Republika e Kosovës	8,9	12,4
Gjakovë	4,1	7,9
Gjilan	3,7	6,7
Mitrovicë	9,7	10,4
Pejë	12,8	8,1
Prizren	8,9	10,2
Prishtinë	9,0	20,5
Ferizaj	5,4	5,3

Sipas anketës, kapaciteti i shfrytëzuar në nivel vendi sipas numrit të shtretërve në Maj 2022 është 12.4%.

Fig. 1: Numri i vizitorëve dhe netqëndrimet e tyre për periudhat 2021 dhe 2022

Shpjegime Metodologjike

Objektivi

Objektivi kryesorë i Hulumtimit të Statistikave të Hotelerisë është paraqitja e trendeve nëpër periudha mujore në këtë sektor në Kosovë. Këta indikatorë ekonomik mundësojnë që të dhënat të jenë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar duke pasur parasysh standardet Evropiane për statistikat mujore.

Përkufizimet

Hotel

Njësi hoteliere është një ndërmarrje, e cila në biznes regjistër është e regjistruar në aktivitetin e hotelerisë. Po ashtu edhe njësitë hoteliere në kuadër të bizneseve private që janë të përfshira në këtë grup. Varësisht nga shërbimet që kryejnë këto njësi janë të ndara në hotele, motele etj.

Turizëm

Turizmi përfshinë aktivitetet e personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë në vende të ndryshme nga vendi i qëndrimit të tyre të zakonshëm për një periudhë jo më të gjatë se një vit kalendarik dhe qëllimi i këtij udhëtimit është kohë e lirë, biznes e të tjera.

Vizitor

Vizitor quhet një person i cili kalon të paktën një natë në një strukturë hoteliere në vendin që ai viziton. Për qëllime të statistikave të turizmit, termi "vizitor" përfaqëson një "person" që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi që ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj. Ai mund të jetë vendor apo i jashtëm.

Vizitor vendor është personi me vendbanim të përhershëm në Kosovë, por i cili qëndron për së paku një natë në një vend tjetër në Kosovë.

Vizitor i jashtëm konsiderohet personi me vendbanim të përhershëm jashtë Kosovës, por i cili qëndron përkohësisht në Kosovë për së paku një natë.

Net-qëndrimi

Një vizitor që kalon një natë brenda një objekti hotelier njihet si net-qëndrim në hulumtimin tonë.

Metodologjia dhe shtrirja e anketës

Anketa e Hotelerisë zhvillohet në baza mujore në tërë territorin e Kosovës. Të dhënat grumbullohen nëpërmjet zyrave rajonale statistikore (gjithsej 7 sish), në mënyrë elektronike dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë të njësive raportuese.

Bazuar në programin statistikor të ASK-ës, merren të dhëna mbi numrin e hoteleve, numrin e të punësuarve, kapacitetet për vendosje (dhoma, shtretër), numrin e vizitorëve dhe netët e qëndrimit sipas muajve si dhe vizitorët e jashtëm sipas vendeve.

Si kornizë për krijimin e mostrës së hotelerisë është përdorur Regjistri i kapaciteteve hoteliere në Kosovë i cili përmban 506 njësi akomoduese. Mostra e vitit 2022 për anketën e hotelerisë përmban 239 njësi akomodimi, të ndara sipas regjioneve. Në muajin Maj 2022 shkalla e përgjigjeve në këtë anketë ishte 86%, 206 hotele kanë dhënë përgjigje në anketë. Të dhënat në këtë publikim janë të ngritura në pesha dhe paraqesin rezultate në nivel vendi.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.